

Kushtet dhe rregullat për Kampionatin e Shahut

Gara do t'i kushtohet shahut, një sport që po rritet vazhdimisht dhe po tërheq interesin e fëmijëve dhe adoleshentëve në mbarë Shqipërinë. Kjo nismë do të prezantohet nga Shtëpia e Evropës dhe do të mbështetet nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri.

Ky kampionat do të bashkojë fëmijë dhe të rinj të moshës 8-18 vjeç për të garuar dhe për të festuar vlerat pozitive që sjell shahu në shoqëri. Ky sport nxit të menduarit kritik, përqendrimin dhe aftësitë hapësinore të nxënësit, pavarësisht prejardhjes së tyre, si dhe ndërton komunitete. Pjesëmarrësit do të ndahen në gjashtë grupmosha. Të rinj nga Tirana, Pogradeci, Korça, Saranda, Fieri dhe Durrësi, si dhe nga qytete të tjera, do të bashkohen në një konkurs me pjesëmarrjen e të dyja gjinive. Turneu do të zhvillohet për tri ditë rresht në Shtëpinë e Evropës, duke kulmuar me shpalljen e fituesve ditën e fundit.

Kriteret për pjesëmarrjen në kampionat / Kush mund të marrë pjesë

Kampionati është i hapur për këdo, nga mosha 8 deri në 18 vjeç, që luan shah në nivel amator apo gjysmëprofesional.

Gara do të shpallet në kanalet e medieve sociale të Delegacionit të BE-së dhe do të ndahet me komunitete të ndryshme të shahut.

Pjesëmarrësit e interesuar mund të regjistrohen duke përdorur linkun e dhënë në faqen e dedikuar të internetit: europeishere.al.

Pjesëmarrësit e përzgjedhur do të njoftohen me email.

Rregullat e lojërave

Gara do të organizohet nga Shtëpia e Evropës me mbështetjen e arbitrave të njohur nga Federata Botërore e Shahut për ndeshjet me sistemin Elo (koeficientët).

Çmimet

- Fituesit do të marrin trofeun dhe medaljet, si dhe një kupon prej 200 eurosh për fituesit e çmimit të parë, për t'u shpenzuar në Megatek .
- Ekipe të vendit të dytë dhe të tretë do të shpërblehen gjithashtu me medalje, si dhe me një kupon prej 150 eurosh për fituesit e çmimit të dytë dhe një kupon me vlerë 100 euro për fituesit e çmimit të tretë, për t'u shpenzuar në Megatek.

- Çdo pjesëmarrës do të marrë një certifikatë pjesëmarrje.

Fituesit do të shpallen nga arbitrat pas përfundimit të lojës së fundit.

Ceremonia e çmimeve

Ceremonia e ndarjes së çmimeve do të zhvillohet ditën e tretë, në Shtëpinë e Evropës. Arbitrat do të ndajnë çmimet e vendit të parë, të dytë dhe të tretë në të gjashtë grupmoshat, duke arritur në 18 çmime gjithsej.

Kushtet dhe rregullat

- **Kualifikimi:** I hapur për gjithë entuziastët e shahut të moshës 8-18 vjeç që luajnë në nivel amator apo gjysmëprofesional.
- **Udhëzime për regjistrimin:** Pjesëmarrësit duhet të regjistrohen nëpërmjet linkut të dhënë deri më **14 qershor 2026**.
- **Të drejtat e autorit dhe të drejtat e përdorimit:** Duke u regjistruar për turneun/konkursin, pjesëmarrësit (dhe kujdestarët e tyre ligjorë) i japin Shtëpisë së Evropës dhe Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri të drejtën për t'i përdorur fotografitë dhe videot e bëra gjatë aktiviteteve për qëllime promovuese dhe arkivore.
- **Gjykimi:** Vendimet e arbitrave janë përfundimtare dhe të detyrueshme.
- **Përgjegjësia:** Organizatorët nuk janë përgjegjës për transportin në dhe nga Shtëpia e Evropës, as për shpenzimet e udhëtimit të bëra nga pjesëmarrësit.
- **Mbrojtja e të dhënave:** Të dhënat personale të ofruara nga pjesëmarrësit do të përdoren vetëm për qëllimin e administrimit të turneut dhe do të trajtohen në mënyrë të sigurt, në përputhje me ligjet në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.

Informacione kontakti:

Për çdo pyetje apo informacion të mëtejshëm, lutemi kontaktoni organizatorët në:
info@europehouse.al

Ceremonia e ndarjes së çmimeve do të dokumentohet dhe do të ndahet publikisht në kanalet zyrtare të medieve sociale të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri (Facebook, X, Instagram dhe LinkedIn).

Ky turne financohet/mbështetet nga Bashkimi Evropian.

Me pjesëmarrjen në Kampionation e Shahut të Europe House, pjesëmarrësit dhe kujdestarët e tyre bien dakord me këto kushte dhe rregulla.